



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-85

PËR PESHKATARI DHE AKUAKULTURË

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kreut 5.1 (j) dhe 9.1 26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9 dt. 15 maj 2001).

Miraton:

LIGJIN PËR PESHKATARI DHE AKUAKULTURË

Kapitulli I
DISPOZITAT E PERGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Me këtë ligj rregullohet menaxhimi me resurse peshkore dhe veprimtaria e peshkatarisë dhe akuakulturës që ushtrohet në ujërat e territorit të Kosovës.

Neni 2

Dispozitat e këtij ligji kanë për qëllim që:

- peshqit në ujërat e peshkimit të shfrytëzohen në mënyrë racionale për tu ruajtur biodiversiteti;
- peshqit mund të peshkohen dhe kultivohen vetëm sipas kushteve të parapara me këtë ligj dhe akteve nënligjore të nxjerra nga ky ligj;
- të përcaktoi kushtet e menaxhimit dhe mbikëqyrjen e resurseve peshkore;
- të përcaktoi masat për mbrojtjen e peshqve,
- të përcaktojë të drejtat dhe obligimet e personave fizikë apo juridikë që ushtrojnë aktivitetin e peshkimit dhe akuakulturës.

Neni 3
Përkufizimet

Nocionet e shfrytëzuara në këtë ligj kanë këto domethënie:

”Ujërat e peshkimit” janë ujërat e lumenjve, prockave, liqeve natyral dhe artificial, kënetave, kanaleve dhe ujërave tjera në të cilat jetojnë peshqit;

”Akuakultura” nënkupton mbarështimin (kultivimin) e organizmave ujor të orientuar për shfrytëzimin e tyre ekonomik;

”**Peshkimi**” nënkupton çdo veprimtari për gjuajtjen e peshkut dhe organizmave tjerë ujor duke përdorur mjete dhe pajisje të ndryshme;

”**Organizma ujor**” janë organizmat e gjallë shtazorë dhe bimor të ngrënë ose të pangrënë që kanë ujin si mjedis jetësor e ku përfshihen peshqit, gaforret, molusqet, ushejzat, bretkosat dhe gjallesat tjera ujore;

”**Peshkim ekonomik**” është peshkimi me qëllim të përfitimit ekonomik;

”**Peshkimi sportiv-rekreativ**” është peshkimi me grepa për rekreacion dhe sport;

”**Peshkëzim**” është hedhja e planifikuar e peshqve në ujërat e peshkimit në bazë të planit vjetor për menaxhim;

”**Peshkatar**” është personi i cili gjuan peshk me mjete dhe pajisje të lejuara në bazë të lejes për peshkim sportiv-rekreativ;

”**Hurdhë e peshqve**” është objekti në tokë bujqësore ose jobujqësore ose në ujërat e peshkimit të dedikuara për mbarështimin e peshqve të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara dhe nuk konsiderohen ujëra të peshkimit në bazë të këtij ligji;

”**Licencë**” është e drejta në bazë të cilit personi fizik apo juridik mund të merret me menaxhim të regjioneve apo zonave të peshkimit;

”**Licencë për akuakultur**” është e drejta për zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës;

”**Licencë për peshkim ekonomik**” është e drejta për peshkim ekonomik në regjionet e peshkimit;

”**Leje për peshkim sanues**” është e drejta që fiton shfrytëzuesi i të drejtues së menaxhimit për sanimin e gjendjes në ujërat e peshkimit;

”**Leje për peshkim shkencor-hulumtues**” e drejta e peshkimit për qëllime shkencore - hulumtuese;

”**Leje**” është e drejta për peshkim sportiv-rekreativ;

”**Shoqata e peshkatarëve**” grup i peshkatarëve të regjistruar që merren me peshkim sportiv-rekreativ;

”**Federata e Peshkatarëve të Kosovës**” bashkim i shoqatave në nivel vendi;

”**Regjion i peshkimit**” pjesë e ujërave të peshkimit që përmban një tersi hidrologjike, biologjike dhe ekonomike që ka kushte për peshkim dhe akuakulturë;

”**Zonë e peshkimit**” është pjesë e regjionit të peshkimit në të cilën shfrytëzohet e drejta për peshkim, akuakulturë dhe mbrojtje të peshqve;

”**Ministria**” është Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;

”**Program i menaxhimit**” masat e parapara për menaxhimin e ujërave të peshkimit në regjionet apo zonat e peshkimit;

”**Plani vjetor i menaxhimit**” masat e parapara të menaxhimit të regjionit apo zonës brenda një viti.

”Kodi i Peshkimit” dokument që përcakton parimet dhe standardet për ruajtjen, menaxhimin dhe zhvillimin e peshkatarisë

Kapitulli II UJËRAT E PESHKIMIT

Neni 4

Ujëra të peshkimit janë të gjitha ujërat në territorin e Kosovës përveç ujërave:

- a) të shpallura si territore të mbrojtura me ligj të veçantë,
- b) në hurdhra të peshqve,
- c) në akumulime, liqene apo burime nga të cilat sipas ligjeve apo vendimeve të veçanta mbrohet burimi për furnizim me ujë të pijes,
- d) në akumulime, liqene apo burime ujore të rezervuara për furnizim me ujë të pijes.

Neni 5

5.1. Ujërat e peshkimit ndahen në regjione apo zona të peshkimit.

5.2. Kufijtë e regjioneve apo zonave të peshkimit, forma e shfrytëzimit për peshkim ekonomik apo sportiv dhe zonat për akuakulturë përcaktohen me akte nënligjore nga ministria duke marr mendimin profesional nga Departamenti i Ujërave të Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor (MAPH).

Neni 6

Regjionet apo zonat e peshkimit mund tu epen në shfrytëzim personave fizik ose juridik, përkatësisht organizatave ose shoqatave për peshkim ekonomik ose sportiv-rekreativ (në tekstin e mëtejme shfrytëzuesit) nga ana e ministrisë.

Neni 7

7.1. Regjioni apo zona e peshkimit i epet në shfrytëzim shfrytëzuesit me tender duke i dhënë të drejtën e menaxhimit nëse i plotëson këto kushte:

- a) të jetë i regjistruar për kryerjen e aktiviteteve në peshkatari,
- b) të jetë i pajisur me pajisje dhe staf profesional për zhvillimin e aktivitetit,
- c) të ketë të organizuara rojet e peshkimit,
- d) të ofroi programin e menaxhimit për regjionin apo zonën e peshkimit.

7.2. Për të fituar të drejtën e shfrytëzimit të regjionit apo zonës së peshkimit ministri nënshkruan kontratë me shfrytëzuesin për kushtet e shfrytëzimit të regjionit apo zonës së peshkimit e cila përmban:

- a) emri i shfrytëzuesit,
- b) emërtimin e regjionit apo zonës së peshkimit,
- c) kufijtë e regjionit apo zonës së peshkimit,
- d) masat për mbrojtjen e resurseve peshkore,

- e) mënyrën e shfrytëzimit të resurseve peshkore,
- f) lartësinë e kompensimit për të drejtën e shfrytëzimit të regjionit apo zonës së peshkimit në bazë të programit të ofruar për menaxhim të resurseve peshkore,
- g) kushtet për ndërprerjen e kontratës.

7.3. Shfrytëzuesi i cili ka fituar të drejtën e shfrytëzimit nuk mund ta bartë këtë të drejtë të subjekti tjetër.

Neni 8

8.1. Kohëzgjatja e të drejtës së shfrytëzimit të peshkimit në regjionin apo zonën e peshkimit mund të zgjat më së shumti dhjet vjet nëse nuk e përcaktohet ndryshe nga ministria.

8.2. Në rastet kur një regjion apo zonë e peshkimit nuk është marrë në shfrytëzim me tender mund të epet në shfrytëzim personave fizik, juridik ose shoqatave të peshkatarëve pa kompensim deri në ritenderim konform nenit 7 të këtij ligji.

8.3. Shfrytëzimi nga paragrafi 2 i këtij neni mund të zgjas më së shumti 2 vite.

Neni 9

9.1. Shfrytëzuesi i të drejtës së peshkimit është i obliguar të vejë shenjat e tij identifikuese në kufijtë e regjionit apo zonës së peshkimit më së largu gjashtë muaj pas fitimit të drejtës së shfrytëzimit dhe nënshkrimit të kontratës.

9.2. Formën e shënjitimit të regjionit apo zonës së peshkimit e përcakton ministria.

Neni 10

10.1. Shfrytëzuesi është i obliguar që brenda një viti nga data e fitimit të drejtës së shfrytëzimit të zbatoi programin e parashtruar për menaxhimin e resurseve peshkore.

10.2. Regjioni apo zona e peshkimit epet në shfrytëzim me kompensim sipas dispozitave të këtij ligji dhe ligjit për koncesione.

10.3. Mjetet e realizuara nga dhënia e të drejtës së shfrytëzimit të regjioneve apo zonave të peshkimit derdhën në Buxhetin e Kosovës.

Neni 11

Programet e menaxhimit

11.1. Programi i menaxhimit hartohet nga shfrytëzuesi i të drejtës së peshkimit në përputhshmëri me Kodin e Peshkimit.

11.2. Programi i menaxhimit miratohet nga ministria për një periudhë jo më shumë se dhjetë vjet dhe paraqet dokumentin bazë për menaxhim në regjion apo zonë të peshkimit dhe ka për qëllim:

- a) të siguroi qëndrueshmëri në shfrytëzimin e burimeve peshkore duke siguruar mirëmbajtjen e tyre në nivele që të plotësojnë nevojat sot dhe në të ardhmen,
- b) të mirëmbaj e të ruaj cilësinë dhe biodiversitetin biologjik të burimeve peshkore dhe organizmave tjerë ujor,

- c) të vlerësoi resurset peshkore si dhe shtimin e peshës,
- d) të planifikoi sasinë vjetore e peshkimit sipas llojeve,
- e) të planifikoi peshkëzimin sipas sasisë dhe llojit të peshqve(koha, sasia dhe lloji i peshqve) si dhe mjetet e nevojshme për zbatimin e planit,
- f) të planifikoi masat dhe mënyrën e mbrojtjes së regjioneve të peshkimit, organizimin e rojeve të peshkimit,
- g) të hartoi planin e punës për ruajtjen e ambientit,
- h) të planifikoi aktivitetet sportive-rekreative,
- i) të planifikoi kohën dhe mënyrën e shtimit të peshqve dhe masat mbrojtëse në vendet e riprodhimit natyral.

11.3. Shfrytëzuesi i të drejtës së peshkimit obligohet që në afat prej 30 ditësh pas nënshkrimit të kontratës të hartoi planin vjetor të menaxhimit i cili duhet të përmbaj:

- a) vlerësimin e sasisë së peshqve dhe shtimin e tyre,
- b) sasinë e lejuar e peshkimit sipas llojeve në vit dhe në dit,
- c) planin e peshkëzimit në sasi sipas llojeve,
- d) mënyrën dhe masat e mbrojtjes së regjionit apo zonës së peshkimit, organizimin e rojeve si dhe planin për ruajtjen e ambientit.

11.4. Plani vjetor i menaxhimit aprovohet nga ministria dhe njoftohet Federata.

11.5. Pa aprovim të planit vjetor të menaxhimit nuk lejohet peshkimi.

Neni 12

12.1. Me qëllim të evidentimit të dhënave për sipërfaqen e regjioneve, kufijtë e regjioneve, sasinë dhe llojet e peshqve, të drejtën e peshkimit në ministri mbahet regjistri i peshkimit i cili rregullohet me akt nënligjor.

12.2. Shfrytëzuesit e të drejtës së peshkimit janë të obliguar të sjellin në ministri të dhënat për regjistrimin në regjistrin e peshkimit sipas paragrafit 1 të të këtij neni .

Kapitulli III PESHKIMI

Neni 13

Mënyra e peshkimit, mjetet dhe pajisjet që përdorën për peshkim përcaktohen me akt nënligjor nga ministria.

Neni 14 Peshkimi ekonomik

Peshkimi ekonomik mund të realizohet në regjionet apo zonat e përcaktuara pas marrjes së licencës për peshkim ekonomik nga ministria.

Neni 15

Me peshkim ekonomik mund të merren vetëm personi fizik apo juridik i regjistruar për peshkim ekonomik, që posedon licencë për peshkim ekonomik.

Neni 16

16.1. Licenca për zhvillimin e veprimtarisë së peshkimit ekonomik epet nga ministria në bazë të aplikacionit të parashtruar.

16.2. Aplikacionit për marrjen e licencës si dhe licenca për peshkim ekonomik duhet të përmbaj:

- a) certifikatën e personit fizik ose juridik,
- b) emërtimi i regjionit ose zonës së peshkimit në të cilën do të zhvillohet peshkimi ekonomik,
- c) llojin dhe numrin e mjeteve dhe pajisjeve që do të përdorën për peshkim ekonomik,
- d) emrin dhe shenjën e regjistrimit të mjetit lundrues me të cilin do të zhvillohet peshkimi ekonomik.

16.3. Forma e aplikacionit dhe mënyra e dhënies së licencës për peshkim ekonomik rregullohet me akt nënligjor nga ministria.

16.4. Licenca për peshkim ekonomik do të epet në bazë të tenderit publik.

16.5. Vendimin për shpalljen e tenderit e bie ministri.

16.6. Procedurën për dhënien e licencës për zhvillimin e peshkimit ekonomik e zbaton komisioni për licenca i emëruar nga ministria.

16.7. Komisioni nga paragrafi 6 i këtij neni i propozon ministrit kandidatët për marrjen e licencës për peshkim ekonomik.

16.8. Shfrytëzuesi i mëparshëm i licencës ka të drejta të njëjta për marrjen e licencës.

16.9. Fituesi i tenderit për zhvillimin e peshkimit ekonomik është i obliguar ti paguaj mjetet shfrytëzuesit për realizimin e peshkimit.

16.10. Mjetet e realizuara nga kompensimi për zhvillimin e veprimtarisë së peshkimit ekonomik janë të hyra të shfrytëzuesit dhe duhet të përdorën për peshkëzimin e ujërave të peshkimit ku është zhvilluar peshkimi ekonomik.

16.11. Në rastet e mos përmbushjes së obligimeve me kontratë dhe mos përmbajtjes në programin e ofruar ministria mban të drejtën e marrjes së licencës.

Neni 17

17.1. Licenca për zhvillimin e veprimtarisë së peshkimit ekonomik nuk mund të bartet te personi ose subjekti tjetër.

17.2. Licenca për zhvillimin e peshkimit ekonomik do ti merret shfrytëzuesit me vendim nga ministria në rast se vërtetohet:

- a) se personi fizik apo juridik që posedon licencën për zhvillimin e veprimtarisë së peshkimit ekonomik nuk posedon mjete dhe pajisje të përshkruara gjatë aplikimit,
- b) se personi fizik apo juridik që posedon licencën për zhvillimin e veprimtarisë së peshkimit ekonomik nuk ka përgatitje profesionale ose nuk ka të punësuar profesional për zhvillimin e kësaj veprimtarie,
- c) se i licencuari nuk i paguan mjetet sipas kontratës,
- d) se nuk i përmbahet programit të parashtruar,
- e) se ujërat e peshkimit në regjionin apo zonat e peshkimit shfrytëzohen për qëllime tjera.

17.3. Procedurën për marrjen e licencës për peshkim ekonomik e ngrit inspektori i blegtorisë, kurse vendimin definitiv e nxjerr ministria.

17.4. Në ministri mbahet regjistri i licencave për peshkim ekonomik.

17.5. Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të licencave për peshkim ekonomik e përcakton ministria.

Neni 18 Peshkimi sportiv-rekreativ

Peshkimi sportiv-rekreativ në ujërat e peshkimit mund të kryhet nga peshkatarët që:

- a) posedojnë leje për peshkim sportiv-rekreativ
- b) kanë provimin për peshkatar sportiv-rekreativ.

Neni 19

Peshkimi sportiv-rekreativ është i ndaluar në rastet:

- a) kur përdorën mjete tjera lundruese nga ato që përcaktohen me akte nënligjore,
- b) kur përdoren pajisje tipike të peshkimit profesional,
- c) në regjione apo zona ku peshkimi sportiv-rekreativ është i ndaluar me akte nënligjore.

Neni 20 Federata e Peshkatarëve Sportiv të Kosovës

Federata e Peshkatarëve Sportiv të Kosovës kryen punët për të cilat autorizohet sipas këtij ligji.

Neni 21

21.1. Federata zbaton masat e zhvillimit dhe mbrojtjes së fondit të peshqve, organizon aktivitete për mbrojtjen e ambientit në territorin ku vepron dhe mban evidencën për provimet e kaluara për peshkim sportiv-rekreativ sipas programit për dhënien e provimit.

21.2. Përveç punëve nga paragrafi 1 të nenit 21 të këtij ligji Federata organizon ndarjen e lejeve për peshkatarët sportiv-rekreativ sipas programit, organizon mbajtjen e garave, zbaton dhe jep leje për të gjitha garat në peshkimin sportiv-rekreativ përveç garave ndërkombëtare, grumbullon të dhënat nga shfrytëzuesit e të drejtës së peshkimit për sasinë dhe llojin e peshkimit nga peshkimi sportiv-rekreativ si dhe jep emblemat dhe dokumentet e identifikimit për rojet e peshkimit sipas kërkesës së shfrytëzuesit.

Neni 22 Provimi për peshkatar

22.1. Federata organizon dhe zbaton provimin për peshkatar sipas programit të përcaktuar nga ministria:

- a) programi dhe mënyra e dhënies së provimit, formulari dhe forma e certifikatës për dhënien e provimit përcaktohet nga ministria,
- b) vlerësimin e njohurve të peshkatarëve sipas programit e bënë komisioni i përzgjedhur nga ministria me propozim të Federatës,
- c) certifikata për dhënien e provimit për peshkatar do ti epet personit i cili ka mbaruar shkollimin profesional në peshkatarë pa obligim të futet në provim.

22.2. Shpenzimet për dhënien e provimit për peshkim sportiv-rekreativ i bartë kandidati.

22.3. Lartësia e pagesës për dhënien e provimit përcaktohet nga ministria.

Neni 23 Lejet për peshkim sportiv-rekreativ

23.1. Për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit sportiv-rekreativ peshkatarët duhet të posedojnë lejen për peshkim.

23.2. Lejet për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit sportiv-rekreativ i lëshon Federata sipas procedurave të përcaktuara nga ministria.

23.3. Peshkatarët për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit sportiv-rekreativ në një regjion apo zonë peshkimi paguajnë lejet tek shfrytëzuesi i të drejtës së menaxhimit të resurseve në regjion apo zonë përmes shoqatave, shoqatave të peshkatarëve apo Federatës.

23.4. Shfrytëzuesi mund të shes lejet për peshkim sportiv-rekreativ:

- a) vetëm për regjionin apo zonën për të cilën ka fituar të drejtën e shfrytëzimit,
- b) vetëm peshkatarëve me provim të kaluar konform nenit 22 paragrafit 1 të këtij ligji,
- c) peshkatarëve të huaj pa provim të kaluar pasi të vërtetoi posedimin e lejes për peshkim nga vendi i cili vjen.

23.5. Shfrytëzuesi i të drejtës së peshkimit përcakton çmimin e lejes për peshkim - sportiv-rekreativ.

Neni 24

Forma, përmbajtja dhe procedura e dhënies së lejes për peshkim sportiv-rekreativ përcaktohet nga ministria me akt nënligjor.

Kapitulli IV AKUAKULTURA

Neni 25

25.1. Aktivitetin e akuakulturës mund ta zhvillojnë personat fizik apo juridik të regjistruar dhe të licencuar për akuakulturë si dhe shfrytëzuesit e resurseve ujore nëse një gjë të tillë kanë planifikuar me program në regjionin apo zonën për të cilën e ka fituar të drejtën e shfrytëzimit.

25.2. Personat fizik apo juridik mund të zhvillojnë aktivitetin e akuakulturës pasi të kenë marrë licencë nga ministria duke i plotësuar këto kushte:

- a) nëse personi fizik apo juridik ka përgatitje profesionale apo ka të punësuar profesional,
- b) kur zbatimi i projektit nuk shkakton efekte negative ndaj mjedisit,
- c) kur zhvillimi i aktivitetit nuk bie ndesh me interesat e sektorëve tjerë që merren me menaxhimin e ujërave,
- d) kur ndryshimi i destinimit të tokave është në përputhje me ligjin e tokave,
- e) kur shfrytëzimi i tokave në pronësi shtetërore rregullohet sipas procedurave të autoriteteve që menaxhojnë me tokat,
- f) kur e drejta e shfrytëzimit të ujërave është rregulluar sipas ligjit për koncesione.

Neni 26

Kërkesës për licencimin e aktivitetit të akuakulturës duhet bashkangjitur:

- a) certifikatën e biznesit të personit fizik apo juridik,
- b) zona - regjioni ku do të zhvillohet aktiviteti,
- c) sasia dhe cilësia e ushqimit që do të përdoret,
- d) lloji i peshqve apo organizmave tjerë ujor që do të kultivohen,
- e) numri dhe data e vendimit për pagesën e koncesionit për shfrytëzimin e ujit si dhe kontratën për koncesione për shfrytëzimin të ujit,
- f) hapësira e hurdhës ku do të zhvillohet veprimtaria,
- g) kontrolli i cilësisë së ujit,
- h) pëlqimi mjedisor nga Ministria e ambientit dhe planifikimit hapësinor (MAPH) për vlerësimin e ndikimit në ambient.

Neni 27

Për zhvillimin e aktivitetit të Akuakulturës kultivuesit obligohen që të sigurojnë:

- a) strukturën e mjeteve dhe pajisjeve që përdorën,
- b) sinjalizimin e sëmundjeve që do të shfaqeshin,
- c) përdorimin e drejt të medikamenteve,
- d) sasia, cilësia dhe llojet e të vegjëlve që do të përdorën,
- e) kufizimin e zonës ku do të zhvillohet veprimtaria,
- f) shkarkimin e çfarëdo materiali të dëmshëm nga hurdha,
- g) mbajtjen e regjistrave dhe paraqitja e informacioneve,
- h) përmbajtje në standardet zooteknike për ngritjen e hurdhës (distanca, forma dhe dimensionet e objekteve për zhvillimin e aktivitetit,

- i) standardet teknike të ndërtimit për pengimin e depërtimit të substancave të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe ambientin,
- j) trajtimin e ujërave të shfrytëzuara.

Neni 28

28.1. Licenca për akuakulturë skadon në rastet kur personi fizik apo juridik ndërpret veprimtarinë dhe në rast të skadimit të kontratës për koncesione për shfrytëzimin e ujit sipas ligjit për koncesione.

28.2. E drejta e licencës mund ti merret kultivuesit i cili kultivon lloje të peshqve ose organizmave tjerë ujor të cilët nuk janë të regjistruar në licencë apo nuk i përmbahet kushteve të parapara sipas nenit 27 të këtij ligji.

Neni 29

Në ujërat e peshkimit në të cilat kultivohet peshku në vendet e rrethuara ku zhvillohet aktiviteti i akuakulturës në largësi prej 50 m prej shenjave për shfrytëzimin e ujit sipas kontratës për koncesione ndalohet peshkimi apo aktivitete tjera.

Neni 30

Në hurdha ku zhvillohet akuakultura ndalohet peshkimi pa lejen e personit përgjegjës të hurdhës.

Neni 31

Ministria mban regjistrin e licencave dhe përcakton formën dhe përmbajtjen e saj.

Neni 32

Kohëzgjatja e licencës për zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës është 10 vite me mundësi të ripërtirjes.

Neni 33

33.1. Çdo modifikim apo zgjerim i aktivitetit, strukturës dhe pajisjeve duhet paraprakisht të merr pëlqimin nga ministria.

33.2. Kriteret për tregtimin me produktet e akuakulturës përcaktohen me akte nënligjore nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në pajtim me Direktivën Nr. 91/67 të EEC të BE-ës.

Kapitulli V MBROJTJA E PESHQVE

Neni 34

34.1. Regjioni apo zona e peshkimit e përcaktuar për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit sportiv-rekreativ mund të shfrytëzohet për zhvillimin e peshkimit sanues në rastet kur duhet penguar shumëzimin e llojeve me vlera të vogla ose shumëzimin e tepërt të një lloji.

34.2. Lejen për aplikimin e peshkimit për sanimin e gjendjes e jep ministria.

34.3. Afati kohor i peshkimit, mënyra e peshkimit, llojet e peshqve dhe sasia e peshkimit rregullohet me akt nënligjor.

Neni 35

35.1. Në ujërat e peshkimit mund të peshkohet edhe për qëllime shkencore-hulumtuese pasi të merret leje nga ministria në bazë të kërkesës dhe programit për qëllimin e hulumtimit.

35.2. Leja për peshkim shkencor-hulumtues duhet të përcaktoj:

- a) në cilat ujëra do të zhvillohet peshkimi,
- b) llojin dhe sasinë e peshkut dhe kohën e peshkimit,
- c) llojin dhe mënyrën e përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve për peshkim.

35.3. Shfrytëzuesi i lejes së peshkimit për qëllime shkencore hulumtuese obligohet të njoftoi Ministrinë dhe shfrytëzuesin e të drejtës së peshkimit në regjionin apo zonën e peshkimit për kohën e peshkimit.

Neni 36

Shfrytëzuesit e të drejtës së peshkimit kanë për detyrë të ndërmarrin masa për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve të peshqve dhe organizmave tjerë ujor si dhe masa për luftimin e dëmtuesve të peshqve sipas dispozitave të ligjit të veterinës dhe akteve nënligjore të nxjerrura nga ky ligj.

Neni 37

37.1. Peshkimi përmes rrymës elektrike (në tekstin e mëtejme elektropeshkimi) në regjionet apo zonat e peshkimit mund të kryhet vetëm në rastet:

- a) e gjuajtjes me qellim të peshkëzimit,
- b) e eliminimit të llojeve me vlera të vogla,
- c) e vlerësimit të stoqeve të peshqve me leje nga ministria.

37.2. Elektropeshkimi mund të kryhet vetëm nga personat profesional për këtë lloj të peshkimit nën mbikëqyrjen e inspektoratit të blegtorisë.

37.3. Me rastin e aplikimit të elektropeshkimit përpilohet procesverbali në vend të ngjarjes në prani të inspektorit të blegtorisë dhe veterinës dhe shfrytëzuesit të drejtës së peshkimit.

Neni 38

Shfrytëzuesi i të drejtës për peshkim sanues, peshkim për qëllime shkencore-hulumtuese si dhe elektropeshkim janë të obliguar që pas përfundimit të peshkimit të raportojnë në ministri për sasinë dhe llojin e peshkut të peshkuar, kohën e peshkimit, vendin dhe mënyrën e peshkimit gjegjësisht mjetet dhe pajisjet e përdorura gjatë peshkim.

Neni 39

39.1. Shfrytëzuesi i të drejtës së peshkimit është i obliguar që për çdo vit të bëjë peshkëzimin e regjionit të marrë në shfrytëzim sipas planit vjetor të menaxhimit.

39.2. Peshkëzimi i ujërave dhe hurdhave duhet të bëhet me peshq, të vegjël dhe ikër - vezë të shëndosh pas kontrollit dhe vërtetimit të cilësisë dhe gjendjes shëndetësore nga institucioni shkencor i autorizuar.

39.3. Peshkëzimi me lloje të reja të peshqve në ujërat e peshkimit aprovohet nga ministria pas marrjes së mendimit nga institucioni shkencor i autorizuar.

Neni 40

40.1. Ndërtimi apo rekonstruimi i digave, objekteve të ekonomive të ujërave apo montimi i pajisjeve në ujërat e peshkimit mund të kryhet me kusht që të sigurohet shumëzimi i papenguar i peshqve dhe organizmave tjerë ujor, mbrojtja e fondit të peshqve dhe migrimi i peshqve.

40.2. Në rast se pengohet migrimi i lirë i peshqve investitori është i obliguar të bëjë peshkëzimin për sajimin e gjendjes për të mundësuar riprodhimin natyral të peshqve.

40.3. Shfrytëzuesit e ujit për kanale të turbinave janë të obliguar të vendosin pajisje për pengimin e depërtimit të peshqve në kanale.

Neni 41

41.1. Në vendet ku bëhet shumëzimi natyral i peshkut ndalohet nxjerrja e rërës, gurëve si dhe ndërmarrja e veprimeve tjera të cilat do të pengonin riprodhimin.

41.2. Në këto vende ndalohen të gjitha llojet e peshkimit përveç peshkimit sanues të paraparë me program me qëllim të zhvillimit të peshqve të llojeve fisnike, të vegjëlve dhe ikrës-vezëve.

Neni 42

Me qëllim të mbrojtjes së peshqve ministria nxjerr akte nënligjore për ndalimin e peshkimit në sezonin e riprodhimit për të gjitha llojet ose për lloje të veçanta në ujërat e peshkimit ose në regjione apo zona të peshkimit si dhe ndalimin e peshkimit të peshqve të cilët nuk kanë madhësinë e duhur.

Neni 43

Mbrojtja shëndetësore e fondit të peshqve në ujërat e peshkimit dhe në hurdhat e peshqve bazohet në dispozitat e ligjit të veterinars si dhe akteve nënligjore të nxjerra nga ky ligj.

Neni 44
Rojet e peshkimit

44.1. Me qellim të ruajtjes së fondit të peshqve në regjionet apo zonat e peshkimit shfrytëzuesi i të drejtës së peshkimit obligohet të organizoi rojet e peshkimit.

44.2. Rojet e peshkimit i emëron shfrytëzuesi i të drejtës së peshkimit për regjionin apo zonën e peshkimit.

44.3. Rojet e peshkimit duhet të kenë njohuri për peshkimin, të kenë të kryer shkollën e mesme të bujqësisë ose veterinës dhe të jenë të trajnuar për peshkatari.

44.4. Shoqatat e peshkatarëve për peshkim sportiv-rekreativ të cilët shfrytëzojnë regjionet apo zonat krahas rojeve të peshkimit mund të ndihmojnë rojet përmes anëtarëve të vet.

Neni 45

45.1. Rojet e peshkimit duhet të pajisen me leje dhe shenjë identifikimi me të cilën dëshmohet identiteti dhe përgjegjësit e tij zyrtare.

45.2. Lejen dhe shenjën e identifikimit rojeve të peshkimit ua jep shfrytëzuesi i të drejtës së peshkimit të regjionit ose zonës.

Neni 46

46.1. Me rastin e kryerjes së detyrave të rojës së peshkimit rojtari është i autorizuar që nga peshkatarët:

- a) të kërkoj lejen për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit,
- b) të kontrolloj mjetet, pajisjet dhe sasinë e peshkut,
- c) të kërkoj dokumentin e identifikimit me të cilën dëshmohet identiteti.

46.2. Në rastet e vërtetimit të peshkimit të kundërligjshëm roja e peshkimit është e autorizuar:

- a) të konfiskoj mjetet dhe pajisjet e peshkimit të cilat janë të ndaluara,
- b) në rast të vërtetimit të peshkimit të peshqve të madhësive të ndaluara ti kthej peshqit në ujë,
- c) në rast se peshku ka ngordhur e nuk është i madhësisë së lejuar të përpiloj procesverbalin për konfiskimin e mjeteve të peshkimit,
- d) në rastet e refuzimit të legjitimitetit të kërkoj mundësi tjera të identifikimit dhe të lajmëroj pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK),
- e) në rastet e vërtetimit të peshkimit me mjete dhe pajisje të ndaluara të siguroj mbështetjen e pjesëtarëve të SHPK-së,
- f) të kontrolloj sasinë maksimale të lejuar të peshkimit.

46.3. Në rastet e vërtetimit të peshkimit në ujërat e peshkimit nga peshkatarët sportiv-rekreativ në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji roja e peshkimit është e obliguar të përpiloj procesverbalin në afat prej tri ditësh dhe t'ia dorëzoj inspektorit të blegtorisë për procedim.

46.4. Personit të cilit përkohësisht i konfiskohen mjetet dhe pajisjet për peshkim i jepet vërtetimi me të dhëna të sakta të pajisjeve, sasisë dhe llojit e peshkut.

46.5. Roja e peshkimit është e autorizuar që mjetet dhe pajisjet e konfiskuara përkohësisht gjatë peshkimit të kundërligjshëm t'ia dorëzoi shfrytëzuesit të drejtës së peshkimit për atë regjion apo zonë.

46.6. Shfrytëzuesi i të drejtës së peshkimit nuk ka të drejtë të tjetërsoi pajisjet e konfiskuara përkohësisht deri në përfundimin e procedurës para organeve kompetente.

46.7. Procesverbali dhe vërtetimi i shërbejnë inspektorit të blegtorisë apo organit kompetent si dëshmi gjatë procesit të parashtrimit të procedurës për kundërvajtje.

46.8. Peshkatarët janë të obliguar të mundësojnë rojeve mbikëqyrje gjatë peshkimit dhe të ofrojnë të gjitha informacionet për kryerjen e detyrave të rojës.

46.9. Në ujërat e regjioneve apo zonave malore ruajtjen e resurseve peshkore e bëjnë rojet e pyjeve të Agjencionit Pyjor të Kosovës.

Neni 47 Ndalimet

47.1. Në ujërat e peshkimit ndalohet:

- a) të peshkohet me mjete eksplozive,
- b) të shkatërrohen të vegjlit e peshqve me vlerë të lartë biologjike në çdo kohë,
- c) të peshkohet me mjete të ndaluara, armë zjarri apo mjete kimike të cilat i vrasin, helmojnë ose joshin peshqit,
- d) ndotja e ujërave të peshkimit me mjete të dëmshme dhe të rrezikshme që mund të ndryshojnë kualitetin e ujit e të cilat e rrezikojnë fondin e peshqve,
- e) hedhja dhe deponimi i materieve të ngurta,
- f) të peshkohen ikrat-vezët, të vegjlit e çdo lloj organizmi ujor pa autorizimin e nevojshëm ose licencën e lëshuar nga ministria,
- g) peshkimi në afërsi më të vogël se 300 m nga digat për hidrocentrale,
- h) të lëshohet uji nga liqenet artificiale apo akumulimet në rast se rrezikohet fauna e ujërave,
- i) pengimi i shpëtimit të peshqve gjatë vërshimeve,
- j) pengimi i vendosjes së shenjave për regjionet apo zonat e peshkimit.

47.2. Ndalimet nga paragrafi 1 i këtij neni nuk vlejnë për rastet e aplikimit të peshkimit për qëllime kërkimore-shkencore.

Kapitulli VI TREGTIMI I PESHQVE

Neni 48

48.1. Tregtimin e peshqve mund ta bëjnë prodhuesit, ndërmarrjet dhe personat juridik të regjistruar për tregtim me peshq.

48.2. Shoqatat, organizatat e peshkatarëve sportiv-rekreativ dhe individët nuk mund ta vejnë në qarkullim peshkun e peshkuar.

48.3. Qarkullimi i peshqve mund të bëhet në objektet e prodhuesit-kultivuesit ose në depot për peshq si dhe në objektet tregtare të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

Neni 49

49.1. Objektet për tregtimin e peshqve duhet të plotësojnë këto kushte:

- a) të jetë i ndërtuar nga materiali i fortë dhe të jetë statik,
- b) hapësira ku ekspozohet peshku të jetë e mbrojtur nga ndikimi direkt i rrezeve të diellit dhe temperaturave të larta,
- c) të ketë të instaluar pajisje për ruajtjen dhe manipulimin me peshk të gjallë, të ngrirë dhe të përpunuar,
- d) të ketë pajisje për ujë të ftohët dhe të ngrohët për mirëmbajtjen e higjienës së objektit, pajisjeve.

49.2. Kriteret për tregtimin me peshq të gjallë, të freskët, të ngrirë dhe të përpunuar përcaktohen me akt nënligjor nga ministria në përputhje me direktivën 91/493 EEC të BE.

49.3. Çështja e higjienës së peshqve të freskët, të ngrirë dhe të përpunuar që tregtohen rregullohet sipas ligjit të veterinës dhe ushqimit.

Kapitulli VII MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI

Neni 50

Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit dhe akteve nënligjore të nxjerrura nga ky ligj ushtrohet nga Ministria.

Neni 51

51.1. Kontrolli i zbatimit të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerrura nga ky ligj ushtrohet nga inspektorati i blegtorisë të Departamentit të Prodhimtarisë Blegtorale në Ministri.

51.2. Zbatimi i dispozitave të këtij ligji dhe akteve të nxjerrura nga ky ligj nga lëmia e mbrojtjes shëndetësore ushtrohet nga inspektorati i veterinës të Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinës - AVUK.

Neni 52

52.1. Inspektimi përfshin:

- a) kontrollin e dokumentacionit të personave fizik apo juridik të cilët ushtrojnë aktivitetin e peshkimit, akuakulturës dhe tregtimit të peshqve dhe organizmave tjerë ujor,
- b) mbikëqyrjen e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës,
- c) mbikëqyrjen e tregut të peshqve dhe organizmave tjerë ujor.

52.2. Inspektimin e shëndetit në mbarështimin dhe tregtimin e peshqve e ushtrojnë inspektorët veteriner.

Neni 53

53.1. Në rastet e vërtetimit të shkeljeve të dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerrura nga ky ligj inspektori:

- a) me vendim urdhëron eliminimin e parregullsive për afat të caktuar,
- b) para organeve kompetente paraqet fletëparaqitjen për shkelje ose bën kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje,
- c) ndërmerr edhe masa tjera të përcaktuara me akte të posaçme që rregullojnë punën e inspektoratit.

53.2. Në rastet kur personi fizik apo juridik në afatin e caktuar nga inspektori nuk i eliminon parregullsitë e përcaktuara sipas ligjit, këto masa mund ti ndërmerr inspektori ose personi fizik apo juridik të cilin e autorizon inspektori kurse shpenzimet për eliminimin e parregullsive i bartë personi fizik apo juridik i cili ka shkaktuar parregullsitë.

Neni 54

54.1. Në rast se vërtetohet shkelja e ligjit dhe dispozitave të nxjerrura nga ky ligj inspektori mund të konfiskoi peshkun dhe organizmat tjerë ujor deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

54.2. Përkohësisht të konfiskoi dhe të vulos mjetet dhe pajisjet për peshkim me të cilat është bërë shkelja e të cilat mund të shërbejnë si dëshmi në procesin gjyqësor.

54.3. Me rastin e konfiskimit të peshkut, mjeteve apo pajisjeve lëshohet vërtetimi.

54.4. Në rastet e konfiskimit të përkohshëm të mjeteve dhe pajisjeve fletëparaqitja gjegjësisht kërkesa për ngritjen e procedurës duhet të kryhet në afat prej 7 ditësh.

Neni 55

Kundër vendimit të inspektorit mund të ushtrohet ankesë në ministri, ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

Neni 56

Shqyrtimi i ankesave bëhet nga komisioni tre anëtarësh i emëruar nga ministria.

Neni 57

Personat fizik apo juridik veprimtaria e të cilëve i nënshtrohet mbikëqyrjes së inspektoratit janë të obliguar të mundësojnë inspektimin e papenguar dhe të ofrojnë të gjithë dokumentacionin dhe informatat e kërkuara.

Neni 58

58.1. Peshkatarët si dhe personat që mbikëqyrin zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerrura nga ky ligj kanë të drejtë qarkullimi në ujërat e peshkimit neper terrene që kufizohen me ujërat e peshkimit.

58.2. Kjo e drejt nuk mund të zbatohet në tokat që janë pjesë e oborreve, kopshteve dhe pemishteve të rrethuara dhe tokave në të cilat me akte të posaçme është i kufizuar ose ndaluar qarkullimi i lirë.

Kapitulli VIII DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 59

Dënohet me gjobë për kundërvajtje personi fizik në shumë prej 200 deri 1.000 € apo juridik në shumë prej 1.000 deri në 5.000 € nëse:

- a) zhvillon aktivitet të peshkimit ekonomik në regjionin apo zonën e peshkimit i cili nuk është definuar si regjion për peshkim ekonomik (neni 14), të këtij Ligji,
- b) zhvillon aktivitetin e peshkimit ekonomik në kundërshtim me nenin 15, të këtij Ligji,
- c) zhvillon aktivitetin e akuakulturës pa licencë (neni 25 paragrafi 2), të këtij Ligji,
- d) zhvillon aktivitetin e akuakulturës pasi ti merret licenca neni 28 paragrafi 1 dhe 2 , të këtij Ligji,
- e) bartë të drejtën e shfrytëzimit te personi ose subjekti tjetër (neni 17 paragrafi 1), të këtij Ligji
- f) kryen ose mundëson elektropeshkimin në kundërshtim me (nenin 37 paragrafi 1), të këtij Ligji,
- g) nuk i parashtron raportin ministrisë për sasinë, llojin, kohën e peshkimit, vendin dhe mënyrën e peshkimit gjegjësisht mjetet dhe pajisjet e përdorura për peshkim (neni 38), të këtij Ligji,
- h) nuk e benë peshkëzimin sipas programit të menaxhimit (neni 40 paragrafi 2), të këtij Ligji,
- i) nëse peshkëzimi bëhet në kundërshtim me (nenin 39 paragrafi 1), të këtij Ligji,
- j) nëse kryen aktivitete të peshkimit në vendet dhe kohën e riprodhimit natyral të peshqve (neni 41) të këtij Ligji,
- k) nëse zhvillon aktivitetin e peshkimit në sezonin kur është i ndaluar peshkimi për lloje të ndryshme të peshqve (neni 42), të këtij Ligji,

Neni 60

Dënohet me gjobë për kundërvajtje personi fizik në shumë prej 100 deri 500 €apo juridik në shumë prej 500 deri në 2.000 € nëse:

- a) fut lloje të reja të peshqve pa pëlqimin e ministrisë (neni 39 paragrafi 3), të këtij Ligji,
- b) nuk shënjon regjionin apo zonën e peshkimit (neni 9 paragrafi 1), të këtij Ligji,
- c) shfrytëzuesi i të drejtës së peshkimit nuk ofron të dhënat konform nenit 12 paragrafi 2 të këtij Ligji,
- d) nuk i përmbahet programit të ofruar për menaxhim (neni 11 paragrafi 1), të këtij Ligji,
- e) gjatë tregtimit me peshq nuk posedon dëshmi për prejardhjen e peshqve,
- f) nuk pajis rojet me shenjen dhe lejen e identifikimit konform nenit 45 paragrafi 1, të këtij Ligji,
- g) kryen peshkimin për qëllime shkencore-hulumtuese pa leje të ministrisë (neni 35 paragrafi 1), të këtij Ligji.

Neni 61

Dënohet me gjobë për kundërvajtje personi fizik në shumë prej 100 deri 500 € apo juridik në shumë prej 500 deri në 1.000 € nëse:

- a) organizon peshkimin sportiv-rekreativ në kohën e riprodhimit natyral (neni 21 paragrafi 2), të këtij Ligji,
- b) nuk zbaton masat për mbrojtjen e fondit të peshqve (neni 21 paragrafi 1),
- c) organizon gara ndërkombëtare pa pëlqimin e ministrisë (neni 21 paragrafi 2), të këtij Ligji.

Neni 62

Dënohen me gjobë për kundërvajtje peshkatarët dhe qytetarët tjerë në shumë prej 100 deri në 200 € nëse:

- a) peshkon në regjionin apo zonën e peshkimit pa leje konform nenit 19 paragrafi 1 pika (c), të këtij Ligji,
- b) peshkon me mjete dhe pajisje të ndaluara (neni 19 paragrafi 1) pika (b),
- c) peshkon në atë mënyrë që e pengon zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës (neni 29), të këtij Ligji,
- d) tejkalon sasinë e lejuar të peshkimit,
- e) tregton me peshkun e peshkuar nga peshkimi sportiv-rekreativ (neni 48 paragrafi 2) të këtij Ligji.

Neni 63

Mjetet e realizuara nga shqiptimi i gjobave sipas dispozitave të këtij ligji derdhën në Buxhetin e Kosovës.

Kapitulli IX
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 64

Ministria obligohet që në afat prej 1 viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji të përcaktoj kufijtë e regjioneve dhe zonave të peshkimit në përputhshmëri me këtë ligj.

Neni 65

Në afat prej një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji ministri do të nxjerr rregulla për:

- a) mënyrën e shënimit të regjioneve apo zonave të peshkimit,
- b) formën, mënyrën dhe përmbajtjen e regjistrave për lejet e shfrytëzuesve të drejtës së peshkimit,
- c) mënyrën, mjetet dhe pajisjet me të cilat zhvillohet peshkimi
- d) formën dhe përmbajtjen e licencave për zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës,
- e) formën dhe përmbajtjen e lejeve për peshkim sportiv-rekreativ,
- f) organizimin e rojeve të peshkimit si dhe formën dhe përmbajtjen e dokumenteve të identifikimit.

Neni 66

Me datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohen ligjet që rregullojnë këtë materie.

Neni 67

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/L-85
10 tetor 2006

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

Kolë Berisha